



MODERNIZIMI NË PRISHTINË

TRASHËGIMIA MODERNE NË PRISHTINË (1960 - 1990) NUMËRON NJË NUMËR TË KONSIDERUESHËM TË SHEMBUJVE TË MIRË TË ARKITEKTURËS MODERNE, PËRCJELLUR ME VLERA KULTURORE, SOCIALE DHE EKONOMIKE QË STIMULUAN DHE SHOQËRUAN NDËRTIMIN E TYRE MEGJITHATË, KJO PJESE E TRASHËGIMISË TONË SHPESH GËZON NJË REPUTACION NEGATIV, E KATEGORIZUAR SI 'E HUAJ' DHE E IMPONUAR. SI REZULTAT I KËTIJ REPUTACIONI NEGATIV, SI DHE FAKTORËVE TË TJERË TË NDËRLIDHUR - SIÇ JANË NDRYSHIMET POLITIKE DHE SHOQËRORE TË PAS VITEVE '99 NË KOSOVË, KRYESISHT TË NDIKUARA NGA PROCESI I PRIVATIZIMIT, NJË NUMËR I KONSIDERUESHËM I OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË MODERNE U DEGRADUAN DHE PJESA E MBETUR VAZHDON TË JETË NË RREZIK TË AMBICIEVE PËR RRËNIM APO ADAPTIM DERI NË TJETËRSIM TË GJENDJES BURIMORE.

ECJE NË TRASHËGIMINË MODERNE TË PRISHTINËS

KTHESE TË RËNDËSISHME NË KËTË SITUATË PARAQET AKTUALIZIMI I KËSAJ PERIUDHE TË TRASHËGIMISË SË PRISHTINËS PËRMES HULUMTIMEVE TË NDËRMARRA SË FUNDMI, AKTIVITETEVE DHE PREZANTIMEVE NË QARQE TË NDRYSHME SOCIALE DHE KULTURORE. PËRFSHIRJA E DISA OBJEKTEVE TË ARKITEKTURËS MODERNE NË PRISHTINË NË PAVIJONIN E KOSOVËS NE BIENALEN E ARKITEKTURËS NË VENEZIA (2014), "FUNDAMENTALS" DHE EKSPOZITËN NDËRKOMBËTARE TË ARKITEKTURËS NË MUZEUN E ARTIT MODERN (MOMA) - USA, "TOWARDS CONCRETE UTOPIA/ARCHITECTURE IN YUGOSLAVIA BETWEEN 1948-1980", DËSHMOJNË PËR FAKTIN SE OBJEKTET MODERNISTE NË PRISHTINË PARAQESIN VLERA ARKITEKTONIKE TË CILAT MERITOJNË TË HULUMTOHEN, DOKUMENTOHEN DHE PROMOVOHEN.

"ECJE NË TRASHËGIMINË MODERNE TË PRISHTINËS" SYNON TË STIMULOJNË NJË 'ECJE VIRTUALE' NË NJË NUMËR TË CAKTUAR TË OBJEKTEVE TË ARKITEKTURËS MODERNE NË PRISHTINË, PËRMES SHPALOSJES SË SHKURTËR TË KUALITETEVE TË TYRE ESTETIKE, FUNKSIONALE, PËRMBAJTJESORE, SOCIALE E KULTURORE. KY UDHËTIM NË NJË 'RRETH' TË OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË MODERNE BËN THIRRJE PËR MË SHUMË VËMENDJE DHE VLERËSIM TË KËSAJ PERIUDHE TË TRASHËGIMISË TONË.



RRETH NESH

EC ANGAZHOHET PËR QËNDRUESHMËRI EKONOMIKE DHE QËVERISJE DEMOKRATIKE NË NIVEL LOKAL (DHE RAJONAL) PËRMES MOBILIZIMIT TË KOMUNITETIT, MBIKËQYRJES SË VENDIMARRJES PUBLIKE DHE PARTNERITETIT NË ZBATIM TË PROGRAMEVE DHE POLITIKAVE ZHVILLIMORE.

MODERNE - INICIATIVA PËR VLERËSIMIN, MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TRASHËGIMISË MODERNE NË KOSOVË, ËSHTË NISMË ME BAZË NË GRUP PROFESIONISTËSH DHE PËRFAQËSUES TË KOMUNITETIT ME QËLLIM TË VLERËSIMIT, MBROJTJES DHE PROMOVIMIT TË TRASHËGIMISË MODERNE NË QENDRAT KRYESORE TË KOSOVËS. QËLLIMI I INICIATIVËS ËSHTË NXITJA E DEBATIT PUBLIK MBI VLERAT E TRASHËGIMISË SË SHEKULLIT XX DHE ZHVILLIMEVE SOCIALE, KULTURORE E EKONOMIKE QË PËRCOLLËN FILLET DHE ZHVILLIMIN E ARKITEKTURËS DHE ARTIT MODERN NË KOSOVË. MODERNE SYNON QË PËRMES HULUMTIMIT, DOKUMENTIMIT DHE KULTIVIMIT TË DISKUTIMIT PUBLIK MBI VLERAT E TRASHËGIMISË MODERNE TË ARRIJË TË KONTRIBUOJË NË MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN KËSAJ PJESE TË RËNDËSISHME TË TRASHËGIMISË TONË.

